

# PYETJE: «A KA VLERË FEJA EDHE PSE MENDONI SE JENI TË LUMTUR PA TË?»

**PËRGJIGJE:** Nëse ju mund ta arrini lumturinë në jetën tuaj pa ndihmën e Perëndisë, atëherë pse duhet ta kërkonit Atë? Ne u ballafaquam shpesh me këtë pyetje gjatë punës sonë misionare në Australi. Gjatë përpjekjeve tona atje për të studjuar Biblën me njerëz të tjerë, ne rrallë u ballafaquam me armiqtë e tyre, por shpesh konstatuam se ata thjesht ishin të paimentuar për studimin e saj. Kur i ftonim njerëzit të vizitonin shërbesat tona të adhurimit të Perëndisë, ata shpesh përgjigjeshin: «Jo, s'më intereson» apo «Thjesht nuk mund ta prishë rehatin tim për këtë». Njerëzit nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur fesë. A duhet që ata të jenë më të vëmendshëm?

Pyetjen e bën më të koklavitur fakti se ata njerëz që nuk i kushtojnë vëmendje fesë shpesh thonë se janë të lumtur. Për shembull, një gazetë në Australi, raportoi se 55% e gjithë të rriturve në Australi ishin «shumë të gëzuar me jetën që bënin», 43% ishin «të gëzuar» dhe vetëm 2% nuk ishin «të gëzuar». I njëjti sondazh në Amerikë tregoi se Amerikanët e konsiderojnë veten po aq të lumtur.

Lumturia e përshkruar më sipër është arritur pa ndihmën e fesë. Shumica e australianëve nuk shkojnë në kishë. Për shembull, australiani i zakonshëm mund të përshkruhet si një njeri i mirë, që ka qejf të shoqërohet me njerëzit dhe t'i ndihmojë ata. Ai është krejt i kënaqur me jetën e tij, përderisa ai mund të shkojë në klube rregullisht, të mbështesë familjen e tij financiarisht, të ketë shtëpinë e tij, të kursejë ca para dhe të ketë kohë të mjaftueshme për kopshtin e tij dhe zbavitjet e tij. Dielli, sërfi në ujë dhe birra, ja cilët janë «zotat» e shumë australianëve. Perëndia i Biblës nuk bën pjesë aspak në jetën e tyre.

Çfarë mendon australiani i zakonshëm për fenë? Për australianin e zakonshëm, feja është vetëm për njerëzit e moshuar, të sëmurë dhe të varfër. Vetëm njerëzit që kanë probleme mendore, fizike apo financiare mund të jenë fetarë. Feja është për ta si një shkop në të cilin mund të mbahen. Dhe, sipas australianit të zakonshëm, feja nuk është për njerëzit e klasës së mesme dhe të lartë, as për të pasurit, as për të fuqishmit dhe as për të zgjuarit! Këta lloj njerëzish nuk kanë nevojë për ndonjë «shkop» ku mund të mbahen. Si rrjedhim, ata nuk janë të interesuar për fenë.

Njerëz me këtë mendësi nuk jetojnë vetëm në Australi. Ata i gjen në Shqipëri, në Itali dhe në çdo vend tjetër. Ata jetojnë ngjitur me ju apo punojnë me ju. Ata i takon kudo, në rrugë, në dyqane, në shkollë etj. Shumica e shqiptarëve i kushtojnë pak ose aspak kohë fesë. Për shumë shqiptarë, Perëndia nuk ekziston. Por edhe nëse ekziston, mendojnë ata, Perëndia nuk ka asnjë lloj fuqie të ndërhyjë në jetën e tyre personale.

A kanë të drejtë ata? A ka ndonjë arsye për të qenë fetar edhe në qoftë se ju mund të jetoni një jetë të lumtur pa qenë i tillë? Përgjigjja ime është: Po, ju duhet të besoni në Perëndi. Po pse?

## SEPSE NJERIU NUK ËSHTË KAFSHË

Në mitologjinë klasike, fauni konsiderohej si një krijesë gjysmë cjan, gjysmë njeri. Ndoshta njerëzit në atë kohë mendonin se ishte e mundur që një njeri të ishte gjysmë kafshë. Por ne kemi më shumë njohuri. Apo jo? Teoria e evolucionit thotë se njeriu në fillim ka ardhur nga një krijesë njëqelizore dhe më vonë nga paraardhës si majmuni. Kjo teori e barazon njeriun me kafshën. Si mund ta

pranojmë ne teorinë e evolucionit?

Për më tepër, ka shumë arsye për të besuar se njeriu si krijesë është ndryshe nga kafshët. Veçanërisht ajo që e dallon njeriun nga kafsha është fakti se njeriu u krijua sipas imazhit të Perëndisë dhe si rrjedhim ai ka një qëllim më të lartë në jetën e tij. «Me anë të të cilave na u dhuruan premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha, që nëpërmjet tyre të bëheni pjestarë të natyrës hyjnore, duke i shpëtuar prishjes që është në botë për shkak të lakmisë» (2 Pjetrit 1:4). Qëllimi i jetës nuk është që të kënaqim natyrën tonë njerëzore, por të fillojmë të marrim natyrën e Perëndisë, që të bëhemi më shumë si Ai. Në qoftë se nuk jemi thjesht kafshë, a nuk duhet të mësojmë çfarë Perëndia do për ne? A nuk duhet të fillojmë dhe t'i besojmë Perëndisë?

### **SEPSE BIBLA NUK ËSHTË NJË PËRRALLË**

Bibla nuk është një përmbledhje me përralla, mite apo legjenda. Shumë njerëz besojnë se ajo është e tillë. Ata e konsiderojnë Biblën si produkt të njeriut, që përmban disa të vërteta, disa gabime, disa fakte nga historia dhe disa mite.

Dy gjëra nuk përputhen me këtë pikëpamje. E para është që Bibla e mohon një ide të tillë. Shiko 2 Timoteut 3:16, 17: «I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.» Çdo fe që pranon Biblën duhet të ballafaqohet me këtë varg që thotë se Bibla nuk përmban përralla. E dyta, në qoftë se Bibla është një përzierje e të vërtetës dhe e gabimit, atëherë asnjë njeri nuk mund të pranojë *ndonjë* pjesë të Biblës si absolutisht të vërtetë. Për shembull, edhe ato të vërteta që besohen me siguri, si hyjnia e Krishtit, ndoshta mund të jenë të pavërteta.

Meqenëse Bibla nuk është një përrallë, fillo ta lexosh, ta kuptosh dhe t'i bindesh asaj. Fillo të besosh.

### **SEPSE TË JESH NJERI FETAR NUK DO TË THOTË THJESHT «T'U BËSH TË MIRA NJERËZVE TË TJERË»**

«Të bësh për shoqërinë» është një shprehje shqiptare. Për shumë njerëz në Shqipëri «miqtë» apo shokët janë të rëndësishëm. Disa herë, ata janë madje më të rëndësishëm se familja. Ky është një

zakon i mirë i shqiptarëve, edhe pse në vitet e fundit, të karakterizuara nga kriza e gjithanshme në Shqipëri, mund të themi se njerëzit që e zbatojnë atë po rrallohen. «Të bësh për shoqërinë» do thotë të kujdesesh për shokët e tu, në veçanti t'u ofrosh ndihmë atyre, kur kanë probleme.

Shumë shqiptarë janë shumë bujarë për të ndihmuar financiarisht të tjerët, për shembull, për të ndihmuar njëri-tjetrin në periudha të shtërngimeve financiare. Ky është veprim i mirë. Megjithatë, shumë njerëz mendojnë se të qenët bujar është gjithçka që kërkohet nga feja. «Përderisa u bëj mirë të tjerëve», mendojnë ata, «kjo, natyrisht, është gjithçka që Perëndia kërkon».

Ju, gjithashtu, njihni njerëz si këta apo jo? Meqenëse ndihmojnë të tjerët, ata besojnë se nuk kanë nevojë të njohin Perëndinë dhe t'i binden Atij.

Natyrisht, Perëndia dëshiron që ne të sillemi mirë me të tjerët. (Shiko Mateu 7:12.) Sidoqoftë, kjo nuk është *gjithçka* që Ai kërkon prej nesh. Ndërkaq që urdhëresa e dytë më e madhe e Perëndisë është: «duaje të afërmin tënd», e para është që të duash Perëndinë me *gjithçka* që ke, me zemrën, shpirtin, mendjen dhe forcën tënde (Marku 12:30, 31). Feja kristiane nuk është thjesht të ndihmuarit e të tjerëve. Shpëtimi me anë të hirit është në qendër të fesë kristiane! Pali e shpjegoi idenë kryesore të fesë sonë si më poshtë: «Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëme, por sipas mëshirës së Tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë» (Titit 3:5). Feja kristiane përqëndrohet rreth shpëtimit dhe ju nuk mund të shpëtoheni thjesht duke bërë mirë. Ju mund të shpëtoheni me anë të mëshirës. Kjo do të thotë se ju duhet të filloni të kërkonti këtë hir dhe t'i kushtoni vëmendje fesë.

### **SEPSE JEZUSI NUK ËSHTË VETËM «I PËRULUR DHE I BUTË»**

Disa besimtarë e shikojnë Krishtin vetëm si «të përulur dhe të butë». Për ta, Krishti është kaq i mirë, i dashur dhe i mëshirshëm sa Ai nuk mund të dënojë ndonjë njeri. Pra, ata nuk mendojnë se duhet të përpiqen për të bërë vullnetin e Tij. Ata mendojnë se Jezusi nuk do t'i ndëshkojë, edhe pse ata nuk bëjnë vullnetin e Tij.

Edhe pse Jezusi në të vërtetë është «i përulur dhe i butë», ekziston një anë tjetër e natyrës së Tij, ajo anë që dikush e ka quajtur «ana e zemëruar» e

Jezusit. Për shembull, mendo për fjalët e gjendura te Gjoni 8:24: «Prandaj ju thashë se ju do të vdisni në mëkatet tuaja, sepse po të mos besoni se unë jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja.» Jezusi besonte se mëkati ekzistonte. Akoma më shumë, Jezusi besonte në ndëshkimin dhe vdekjen që vjen si rezultat i mëkatit. Ai tha se disa do të ndëshkohen. Jezusi madje vendosi kushte që, në qoftë se nuk plotësoheshin, do të rezultonin në ndëshkim. Madje Jezusi tha se është e nevojshme t'i bindesh Perëndisë, nëse kërkon të shpëtohet (shiko Mateu 7:21). Atëherë, meqenëse Jezusi ndëshkon ata që nuk i binden Perëndisë, unë duhet të bëj vullnetin e Tij dhe kjo është çfarë unë nënkuptoj me të qenit fetar.

### SEPSE BESIMI NUK ËSHTË NJË SHKOP MAGJIK

Një teori popullore thotë se nëse ju besoni te Jezusi, çdo gjë do të rregullohet. E vetmja gjë që mund të bëni për t'u shpëtuar është të besoni. Ju do të shpëtoheni nëse pranoni se Jezusi është Zot dhe besoni në hyjninë e Tij, pavarësisht nga gjërat e tjera që bëni apo nga ato që nuk arrini t'i bëni.

Por, vetëm besimi *nuk* do t'ju shpëtojë (Jakobit 2:24) megjithëse ai është thelbi i kristianizmit (Gjoni 3:16). Besimi mund t'ju shpëtojë vetëm nëse është një besim që vepron nëpërmjet dashurisë (Galatasve 5:6). Ju nuk shpëtoheni menjëherë në çastin kur filloni të besoni Jezusin si Birin e Perëndisë. Por, pasi të keni besuar në të, duhet të lini besimin tuaj t'ju udhëheqë për t'ju bindur vullnetit të Tij. Kur të zbatoni vullnetin e Perëndisë, për arsye të besimit tuaj, atëherë ju jeni shpëtuar dhe jo përpara kësaj. Te Veprat 2, shumë njerëz e besuan atë që Pjetri predikoi rreth Krishtit. Ata besuan se Jezusi me të vërtetë ishte hyjnor dhe Krisht. Kështu ata pyetën: «Çfarë duhet të bëjmë?» Pjetri *nuk* u tha këtyre hebrenjve se ata kishin bërë gjithçka që ishte e nevojshme dhe kështu ata ishin tashmë të shpëtuar. Ai u tha këtyre *besimtarëve*: «Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë» (Veprat 2:38). Vetëm besimi nuk ishte i mjaftueshëm. Pendimi dhe pagëzimi ishin gjithashtu të domosdoshëm si akte të bindjes ndaj vullnetit të Perëndisë. Meqenëse ne duhet t'i bindemi Atij, kjo është një arsye e mirë për të besuar në fenë.

### SEPSE PERËNDIA NUK ËSHTË PLAKU I VITIT TË RI

Disa madje mendojnë se Perëndia ka shumë gjëra të ngjashme me Plakun e Vitit të Ri, plakun e mirë me mjekër të bardhë i cili u «sjell» dhurata njerëzve për Vitin e Ri. Ne të gjithë e dimë se Plaku i Vitit të Ri u jep dhurata të gjithë djemve dhe vajzave të vogla, pavarësisht se sa të këqinj apo të mirë ata kanë qenë gjatë gjithë vitit. Plaku i Vitit të Ri nuk vë kushte. Sido që të jetë, Plaku i Vitit të Ri do të gjejë një mënyrë për të anashkaluar të keqen e fëmijëve dhe ai prapë do t'u japë lodra atyre.

A mendojmë ne se Perëndia është si Plaku i Vitit të Ri? E dimë se Ai do t'i bekojë ata që jetojnë një jetë të mirë, një jetë të bindur ndaj urdhërimeve të Tij. Por, sidoqoftë, ne mendojmë se Ai do të gjejë një mënyrë për të bekuar secilin, pavarësisht se sa të mirë apo të këqinj kanë qenë në jetë. Unë kam dëgjuar një shprehje që thotë: «Nuk ka ndonjë jobesimtar në folenë e miut (do të thotë që çdo njeri, kur gjendet keq, i drejtohet në një formë apo tjetër Perëndisë për ndihmë).» Ose, duke u nisur nga fjalimet që mbahen përpara varrit të të vdekurit ne mund të shtojmë këtë: «Nuk ka asnjë nga ata që kanë vdekur që të ketë qenë i keq gjatë jetës së tij.» Kjo ndodh, sepse njerëzit flasin mirë për një të vdekur, edhe në qoftë se ai jetoj një jetë të keqe dhe me mëkate. Pavarësisht se sa i keq ka qenë një njeri në jetë, ne gjithmonë jemi të prirur të besojmë se Perëndia do të gjejë një mënyrë që ta falë dhe t'i japë një vend në qiell pas vdekjes. Ne e mendojmë Perëndinë si një xhemtëlmën të moshuar, si një gjysh, i cili gjithmonë thotë: «Në qoftë se këmbëngulni, bëjeni atë që dëshironi të bëni, nuk do të ketë ndonjë problem për ju. Unë do t'ju falë.»

Perëndia nuk është i tillë! Perëndia është i mirë dhe i dashur. Por Perëndia është më shumë se kaq. Perëndia gjithashtu është i drejtë! Dhe drejtësia e Perëndisë kërkon që herë pas here Ai duhet të jetë i rreptë dhe ndëshkues, po aq sa është i mëshirshëm dhe falës. Bibla flet për «mirësinë dhe rreptësinë e Perëndisë» (Romakëve 11:22). Bibla thotë: «Gjë e tmerrshme është të bjerë njeriu në duart e Perëndisë së gjallë» (Hebrenjve 10:31). Ju nuk mund të bëni çfarë të doni dhe të mos jepni llogari për të. Sepse Perëndia është i drejtë. Ai do të ndëshkojë mëkatarët e papenduar që nuk janë falur nga mëshira e Tij. Pra, kini besim!

## SEPSE VDEKJA NUK ËSHTË FUNDI

Shumë njerëz besojnë se njeriu është si një qen i vjetër që, kur vdes, vdes përgjithmonë. Në qoftë se kjo është e vërtetë, nuk ka ndonjë arsye për të qenë fetar. Ne mund të bëjmë në jetë gjithçka që duam, sepse nuk do të na kërkohet llogari pas varrit. Ata lloj njerëzish nuk besojnë se ka ndonjë arsye për të vënë në jetë vullnetin e Perëndisë.

Por vdekja nuk është fundi i ekzistencës sonë. Ne jetojmë përtej varrit. Bibla thotë: «Dhe, duke qenë se është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë dhe më pas vjen gjyqi» (Hebrenjve 9:27). Pas vdekjes, gjykimi do të vijë dhe ne të gjithë duhet të qëndrojmë përpara Perëndisë dhe të japim llogari për çfarë kemi bërë në tokë. Ne *do të* gjykohe mi. Ne *do ta* kalojmë përjetësinë ose në qiell ose në ferr. A nuk është kjo një arsye e mjaftueshme që të fillojmë të bëjmë vullnetin e Perëndisë?

## SEPSE NUK JENI TË PLOTFUQISHËM

Mendoni për njeriun që e di se është i humbur dhe që e di se çfarë duhet të bëjë për të shpëtuar, por megjithatë ai nuk bën çfarë duhet të bëjë me pretekstin se do të bëjë gjithçka që duhet në të ardhmen. Ai thotë: «Ndoshta javën tjetër, muajin tjetër apo vitin tjetër. Pastaj do të vij te Krishti dhe do të filloj t'i shërbej Perëndisë. Pastaj do të bëhem besimtar.» Ky njeri mendon se është i plotfuqishëm dhe ka kontroll të plotë mbi jetën. Ai mendon se mund të drejtojë kohën, jetën, sëmundjen dhe vdekjen. Asgjë nuk e shqetëson atë. Sëmundja serioze? Jo, ai nuk do të sëmuret. Aksident? Jo, ai mund ta sigurojë veten e tij se s'do të ketë ndonjë aksident. Tragjedi? S'është problem, me një lëvizje dore ai e mënjanon tragjedinë. Vdekje e parakohshme? Natyrisht ai nuk duhet të shqetësohet fare për të. Në fund të fundit, ai është i sigurt se do të jetojë për një kohë të gjatë për të bërë gjithë gjërat e mira që ai dëshiron të bëjë, ndërmjet të cilave është të bëhet kristian.

Në qoftë se mendoni në këtë mënyrë, miqtë e mi, ju po gënjoni veten. Jakobi thotë: «Ndërsa nuk dini për të nesërmen. Sepse ç'është jeta? Është avull që duket për pak dhe pastaj humbet» (Jakobit 4:14). Asnjeri nuk është i plotfuqishëm. Asnjë nuk mund të jetë i sigurt se sëmundjet, aksidentet, tragjeditë apo vdekja e parakohshme nuk do të vijnë në jetën e tij përpara se të ketë plotësuar të gjitha qëllimet e jetës së tij. Ju *nuk* jeni të plotfuqishëm. E vetmja

mënyrë që mund të siguroheni se keni kohë të mjaftueshme për t'u kthyer te Krishti është që të afroheni tek Ai sot. Pranojeni Krishtin ashtu siç është dhe bëhuni besimtarë sot.

## SEPSE NJERIU, THELLË NË VETVETE, ËSHTË FETAR

Kjo do të thotë që të detyrosh dikë që të jetë fetar është, në një farë kuptimi, e tepërt. Ju, si çdo njeri tjetër në këtë botë, jeni ndërkohë fetarë.

Kjo mund të ilustruhet prej kapitullit të parë të librit të Romakëve, ku Pali tregon për disa njerëz mëkatarë, që ishin fajtor për llojet më të këqija të mëkateve. Ata mohuan Perëndinë dhe kështu Perëndia i mohoi ata. Ata ishin vrasës, të poshtër, shpifës, homoseksualë, njerëz që urrenin Perëndinë, etj. Pra, a duhet të arrijmë në përfundimin se ata nuk ishin fetarë? Shiko Romakëve 1:25: «Që e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtër dhe adhuruan dhe i shërbyen krijesës në vend të Krijuesit, që është i bekuar përjetë.» Ata akoma nderonin, edhe pse ishin fajtor për mëkatin! Ata thjesht nderonin atë që s'duhej, krijesën, në vend të Krijuesit. Çdo njeri nderon diçka! Në qoftë se ai nuk nderon Krijuesin, ai nderon krijesën.

Sot njerëzit nderojnë gjëra të ndryshme. Disa nderojnë *paranë*. Ata mendojnë se paraja do t'ju sjellë gëzim. Kështu, ata japin jetën e tyre për t'i shërbyer asaj. Të tjerët nderojnë *kënaqësinë*, ata janë të interesuar vetëm që t'ia kalojnë mirë. Disa nderojnë *shkencën*, ata e shikojnë shkencën si burimin e gjithë përgjigjeve. Sipas tyre, nëse ne mund të përparojmë më shumë në teknologji apo të mësojmë më shumë gjëra të reja nga shkenca, ne do të jemi në gjendje të krijojmë parajsën në tokë. Dhe disa nderojnë *mëkatin*. Mëkati i ka skllavëruar dhe mundur ata dhe asgjë tjetër nuk u intereson më. Pra, e vërteta është se çdo njeri nderon diçka.

Kështu, zgjedhja juaj nuk është nëse do të nderoni apo jo, do të nderoni dikë apo diçka, zgjedhja është *kë* apo *çfarë* do të nderoni. Jezusi e shpjegoi zgjedhjen në këtë mënyrë: «Askush nuk mund t'u shërbejë dy zotërinjve, sepse ose do të urrejë njërin dhe do të dojë tjetrin, ose do t'i qëndrojë besnik njërit dhe do të përçmojë tjetrin, ju nuk mund t'i shërbeni Perëndisë dhe mamonit» (Mateu 6:24). Ju duhet të zgjidhmi: Perëndinë apo gjërat materiale, Krijuesin apo krijesën. Cila do të jetë zgjedhja juaj?

## KONKLUZIONI

Pse, kur jeni përpara një zgjedhjeje të tillë, ju duhet të vendosni t'ï shërbeni Perëndisë? A mund të jeni të lumtur pa e bërë këtë? Po, me sinqeritet, unë besoj se ju mund të jeni të lumtur në një farë mase pa i shërbyer Perëndisë. Por unë besoj se jeta e plotë, e lumtur dhe me kuptim vjen kur i shërbeni Perëndisë. Më pëlqen mënyra se si Jezusi u shpreh:

Në të vërtetë po ju them që nuk ka asnjëri që të ketë lënë shtëpinë, a vëllezërit a motrat, a atin, a nënën, a fëmijët ose arat për hirin tim dhe për ungjillin, që të mos marrë tani, në këtë kohë, njëqindfish shtëpi, vëllezër, motra, nëna, fëmijë e ara, së bashku me përndjekje dhe në botën e ardhme, jeta e përjetshme (Marku 10:29, 30).

Kristianizmi nuk sjell thjesht bekime për jetën e ardhme. Kristianizmi ofron bekime të mrekullueshme për jetën në tokë.

Por kristianizmi ofron diçka që asnjë tjetër

s'mund ta ofrojë: «. . .dhe në botën e ardhme, jeta e përjetshme?» Madje, edhe *në qoftë se* jeni të lumtur njësoj si të jetoni pa Krishtin dhe si të jetoni me Të, prapë do të përfitoni po të zgjidhni Zotin në vend të gjërave materiale, sepse asgjë në botë, *përveç* Krishtit, nuk mund t'ju marrë në qiell.

Dhe ju duhet ta zgjidhni Atë sot. Jozueu i sfidoi njerëzit e izraelit duke u thënë: «Zgjidhni sot kujt doni t'ï shërbeni» (Jozueut 24:15). Kaq shumë njerëz duan ta shtyjnë vendimin për të ndjekur Jezusin. Ata duken sikur thonë: «Unë do të të ndjek Ty, në rregull, por pak më vonë, jo tani.» Si mund ta dini ju se do të keni kohë në vonë? Dita e sotme është gjithçka që keni. Sot është dita juaj për të zgjedhur Krishtin. Ju duhet të merrni një vendim. Në fakt, ju do të merrni një vendim. Në fakt, në qoftë se nuk do të zgjidhni Krishtin sot, ju keni zgjedhur botën. Ju nuk mund të jeni neutral. «Zgjidhni për veten tuaj», zgjidhni Krishtin!

Autor: *Coy Roper*

Marrë nga studimi: *"Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"*

© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara